

**PROGRAM ZBATIMI I BASHKËPUNIMIT KULTUROR NDËRMJET QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË ITALISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
PËR VITET 2022-2025**

*Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, në vijim të quajtura "Palët", në përputhje me sa parashikohet nga neni 14 i Marrëveshjes Kulturore të firmosur në Tiranë më 12 shtator 1994, me qëllimin për të zhvilluar shkëmbimet në fushën e kulturës dhe të arsimit dhe për të kontribuar në këtë mënyrë në thellimin e lidhjeve të miqësisë mes dy Vendeve dhe Popujve, kanë rënë dakord për Programin e bashkëpunimit kulturor për vitet 2022-2025.*

## **1. ARSIMI**

### **1.1. Arsimi i lartë**

1.1.1. Palët do të ndihmojnë realizimin e nismave të bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të arsimit të lartë përmes lidhjes së marrëveshjeve, duke nxitur në këtë drejtim titujt e dyfishtë të studimit dhe titujt e përbashkët të studimit, lëvizshmërinë akademike si dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve edhe nëpërmjet realizimit të projekteve të përbashkëta kërkimore, të seminareve dhe kongreseve. Do të lehtësojnë për këtë qëllim kontaktet dhe shkëmbimet e përvojave ndërmjet Konferencës së Rektorëve të Universiteteve italiane dhe Konferencës së Rektorëve shqiptarë.

1.1.2. Palët bien dakord për faktin se bashkëpunimi dypalësh mes Italisë dhe Shqipërisë do duhet të inkurajohet dhe rritet edhe në këndvështrimin e sfidave të reja dhe mundësive të ofruara nga programet e shkëmbimit të Bashkimit Evropian dhe programeve të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe në dritën e detyrimeve të parashikuara nga përkatësia e përbashkët në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) dhe nga Konventa për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë, firmosur në Lisbonë, më 11 prill 1997.

Palët urojnë vijimësinë e bashkëpunimit jo vetëm përmes programeve aktuale ekzistuese në Evropë për lëvizjen, duke iu referuar veçanërisht programit Erasmus Plus dhe për kërkimin referuar programit Horizon 2020, por edhe duke mbështetur në rrafsh evropian përfundimin e programeve të reja të mundshme të përbashkëta. Në këtë kuptim, Palët miratojnë bashkëpunimin e mirë që u bë i mundur nga Programi IPA II i cili çeli një dritare në Programin Evropa Krijuese 2014-2020 e që synonte projekte bashkëpunimi kulturor, që ka kontribuar në qarkullimin e veprave të artistëve të sektorëve kulturorë e krijues dhe në dialogun ndër-kulturor.

1.1.3. Palët do të shkëmbejnë çdo vit deri në 5 përfaqësues të personelit akademik dhe/ose kërkues shkencorë për secilën palë, për vizita me një kohëzgjatje jo më të madhe se tetë ditë, për projekte me interes të përbashkët (**shih Aneksi II a**).

## **1.2. Arsimi dhe formimi**

1.2.1. Me qëllimin për të ndihmuar njohjen e kulturave përkatëse, të sistemeve të arsimit dhe edukimit si dhe të metodave të mësimdhënies, Palët do të shkëmbejnë dokumentacion, libra, materiale audiovizive dhe material tjetër mësimor, edhe me qëllimin që të mbërrijnë në një marrëveshje të mundshme në lidhje me njohjen e ndërsjellë të titujve të studimit që do të realizohej në bazë të sa parashikohet nga Rekomandimi i Këshillit Evropian, i datës 26 nëntor 2018.

1.2.2. Në periudhën e vlefshmërisë së këtij Programi, Palët do të mund të shkëmbejnë, në përputhje me burimet financiare të buxhetit, deri në 2 drejtues të nivelit të lartë në sektorin e arsimit, për vizita me një kohëzgjatje jo më të madhe se shtatë ditë, me qëllim që të studiohet sistemi arsimor i Vendit tjetër dhe për të dakordësuar programe të mundshme specifike shkëmbimi. Për Palën italiane, Administrata përgjegjëse është Ministria e Arsimit. Për Palën shqiptare, Administrata përgjegjëse është Ministria e Arsimit dhe Sportit.

## **1.3. Mësimdhënia e gjuhëve italiane dhe shqipe**

1.3.1. Palët, në përputhje me burimet e tyre financiare, do të promovojnë përhapjen e gjuhëve dhe kulturave përkatëse në Vendin tjetër edhe përmes katedrave dhe lektorateve pranë Institucioneve të arsimit të mesëm dhe Institucioneve të arsimit të lartë. Ato do të shkëmbejnë libra, materiale mësimore për mësimdhënien e gjuhëve përkatëse dhe informacione mbi risitë e përfuara në sektorët pedagogjik dhe mësimor, në kufijtë e burimeve të disponueshme.

1.3.2. Palët konfirmojnë interesin e përbashkët për të promovuar dhe përhapur gjuhën dhe kulturën shqiptare në shkollat italiane të ndjekura nga nxënës që i përkasin komuniteteve të pakicës etno-gjuhësore të arbëreshëve të Italisë. Për këtë qëllim, secila Palë është e gatshme, në pajtim me burimet e veta financiare parashikuar në bilancet buxhetore, të promovojë dhe financojë kurse trajnimi për mësues të gjuhës italiane në Shqipëri dhe mësues të gjuhës shqipe në Itali.

Për këtë qëllim Pala shqiptare konfirmon angazhimin e vet për të promovuar dhe zhvilluar mësimdhënien e gjuhës italiane si gjuhë e parë e huaj në sistemin shkollor shqiptar, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, për Programin "Iliria", rifikosur më 18 maj 2021 në Tiranë. Pala italiane angazhohet të mbështesë këtë program në kufijtë e burimeve të disponueshme. Në kuadër të interesit të përbashkët për të promovuar dhe përhapur gjuhën dhe kulturën shqiptare në shkollat italiane, Pala italiane konfirmon angazhimin e vet për të promovuar dhe zhvilluar mësimdhënien e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj fakultative jashtë kurrikulare në sistemin shkollor italian, që do të realizohet në përputhje me Programin trevjeçar të planit mësimor të institucioneve shkollore e në kufijtë e burimeve profesionale të disponueshme, sikurse kërkohet gjerësisht nga nxënësit me kombësi shqiptare apo nga ata që i përkasin komuniteteve të pakicës etno-gjuhësore të arbëreshëve të Italisë.

Pala shqiptare angazhohet të mbështesë këtë mësimdhënie në kufijtë e burimeve të disponueshme.

Palët do të mbajnë parasysh gjithashtu sinergjitë e mundshme me nisma të tjera bashkëpunimi në kuadër dypalësh, komunitar dhe shumëpalësh. Palët do të ndihmojnë ndër të tjera mundësitë për binjakëzim mes Institucioneve të arsimit parauniversitar shqiptare dhe italiane dhe do të përcaktojnë instrumentet e nevojshme për realizimin e këtij objekti.

1.3.3. Palët njohin që janë të pranishëm në Shqipëri dy lektorë të gjuhës italiane, të dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, që ofrojnë shërbimin e tyre pranë Universitetit të Tiranës dhe pranë Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë. Palët njohin gjithashtu dy lektorë të gjuhës shqipe që ofrojnë mësimdhënien e tyre pranë Universitetit të Kozencës dhe Palermos.

1.3.4. Pala italiane do të vlerësojë mundësinë, në pajtim me burimet e tyre financiare, që të vijojnë të japin kontribute të përshtatshme financiare për Institucionet e arsimit të lartë dhe Institucionet e arsimit parauniversitar shqiptare për krijimin dhe mbajtjen e departamenteve të gjuhës italiane.

Ajo do të shqyrtojë gjithashtu mundësinë, në pajtim me disponibilitetin financiar, për të dhënë financime për Institucione të arsimit parauniversitar dhe Institucione të arsimit të lartë të Shqipërisë me qëllim që të organizohen, në vend apo në distancë, kurse trajnimi dhe azhurnimi për mësues të gjuhës italiane.

1.3.5. Palët njohin me kënaqësi funksionimin në Shqipëri të seksioneve dygjuhëshe italo-shqiptare me mësimdhënie të gjuhës italiane dhe të disa lëndëve në gjuhën italiane, siç parashikohet në Memorandumin e Mirëkuptimit të firmosur në Tiranë më 14 janar 2011 (plotësuar me Shtojcën e datës 7 korrik 2011) dhe rinovuar në vitin 2021, që përfshin klasat nga e VI-të (arsimi bazë) deri në të XII-ën në këto institucione shkollore: Shkolla e Mesme "Ismail Qemali" dhe shkollat 9 vjeçare "Pjetër Budi" dhe "Shkolla e Kuqe" në Tiranë; shkolla e mesme "Themistokli Gërmenji" dhe shkollat 9 vjeçare "Pandeli Cale" dhe "Sevasti Qiriazi" në Korçë; shkolla e mesme "28 Nëntori" dhe shkollat 9 vjeçare "Ndre Mjeda" dhe "Ismail Qemali" në Shkodër. Palët njohin me kënaqësi praninë e "Shkolla Italiane në Tiranë", shkollë fillore dygjuhëshe me vit parashkollor, krijuar në vitin 2018 dhe falë një *joint venture* me Shoqërinë Dante Alighieri, që ndërmori procedurën për çeljen e ciklit të arsimit të mesëm të ulët.

Pala italiane është e gatshme të mbështesë këto seksione përmes caktimit të mësuesve italianë, të materialit mësimor dhe të financimeve për kurse trajnimi për mësues vendas, në kufijtë e zërave financiarë në bilanc dhe në respektim të kritereve të funksionimit të seksioneve dygjuhëshe të dakordësuara më parë, apo që do të dakordësohen në vijim, me Palën shqiptare me ndryshimin apo plotësimin e marrëveshjeve në fuqi sipas mënyrave këtu të treguara.

1.3.6. Pala italiane (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar - Drejtoria e Përgjithshme për Diplomacinë Publike dhe Kulturore) do të shqyrtojë pozitivisht mundësinë për të ofruar tekste të italianistikës, si dhe materiale të tjera mësimore që kanë si qëllim mësimdhënien e gjuhës italiane, edhe në format digjital,

për ato Institucione të arsimit parauniversitar dhe Institucione të arsimit të lartë shqiptare që do të paraqisin kërkesë të qartë në rrugë diplomatike, në kufijtë e burimeve të disponueshme.

Pala italiane do të shqyrtojë mundësinë për të dhënë kontribute financiare për organizimin e kurseve të trajnimit dhe azhurnimit për mësues dhe lektorë të gjuhës italiane, edhe në distancë, për ato institucione që do të paraqisin kërkesë në rrugë diplomatike.

1.3.7. Pala shqiptare është e gatshme të presë çdo vit të paktën 3 mësues italianë të gjuhës shqipe që mendojnë të ndjekin kurse verore të organizuara nga Institucionet e arsimit të lartë shqiptare. Shpenzimet për ndjekjen e kursit dhe për qëndrimin do të jenë në ngarkim të Palës shqiptare.

1.3.8. Pala italiane angazhohet t'u sigurojë studentëve shqiptarë në Itali të njëjtin trajtim që u ofrohet studentëve të Vendeve të tjera që ndodhen në fazën e para-antarësimit (IPA).

1.3.9. Shoqëria "Dante Alighieri", në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në bazë të bashkëpunimit me "Shkollën Italiane në Tiranë" parashikon të vazhdojë të mbështesë projektet e ndërmarra tashmë për promovimin e gjuhës dhe të kulturës italiane përmes organizimit të aktiviteteve mësimore dhe kulturore, përditësimit të bibliotekave, promovimit të Planit të Kurseve ADA (Dëshmi Dante Alighieri), përhapjes së çertifikatës PLIDA (Projekti Gjuha Italiane Dante Alighieri), në kuadrin e sistemit CLIQ, për certifikimin e aftësisë në gjuhën italiane provimet për të cilën kryhen në Shqipëri pranë qendrave PLIDA të autorizuara, dhënies së bursave të studimit për studentë dhe mësues të gjuhës italiane.

1.3.10. Instituti Italian i Kulturës në Tiranë përfaqëson Universitetin për të Huaj në Peruxha, Universitetin për të Huaj në Siena dhe Universitetin Roma III me qëllim dhënien e çertifikatave të njohjes së aftësive në gjuhën italiane CELI, CILS dhe ROMA III, në kuadrin e sistemit CLIQ.

Pala shqiptare njofton Institutin Italian të Kulturës se, për njohjen e testeve të gjuhës italiane si më sipër, duhet të plotësojë kushtet sipas legjislacionit kombëtar shqiptar në fuqi (Udhëzimi nr.52/2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar).

## 2. BURSA STUDIMI

2.1. Pala italiane do mund të japë çdo vit, në pajtim me fondet e disponueshme në buxhet, bursa studimi mujore sipas mënyrave të treguara në njoftimin e shpalljes për dhënie të bursave të studimit.

Pala italiane do të njoftojë çdo vit, në rrugë diplomatike, numrin e muajve, shumat dhe kushtet e dhënies së këtyre bursave të studimit (shih Aneksi II b).

2.2. Shkolla Arkeologjike Italiane në Athinë do të shohë mundësinë për të pranuar një bursist/e shqiptar/e për të ndjekur kurset dhe për t'i dhënë bursistit/es mikpritje dhe asistencë mësimore dhe shkencore.

2.3. Pala shqiptare do të japë çdo vit, në përputhje me buxhetin në dispozicion, bursa studimi mujore për të diplomuar dhe për studentë italianë për vazhdimin e programeve master, kurseve të specializimit dhe kandidatë për kërkim dhe kurse të gjuhës shqipe.

### **3. SPORTI**

3.1. Me qëllim përhapjen e përvojave në fushën e sportit, Palët do të nxitin marrëdhëniet mes Institucioneve përkatëse përgjegjëse dhe do të ndihmin shkëmbimin e delegacioneve, të atletëve, trajnerëve dhe ekspertëve të tjerë sportivë, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes organeve përgjegjëse. Shpenzime të mundshme lidhur me organizimin e këtyre kontakteve do të përballohen nga Pala kërkuese.

Në sektorin e sportit Institucionet përgjegjëse për Italinë janë:

- C.O.N.I (KONI) - Komiteti Olimpik Kombëtar Italian
- Qarqet, në kuadrin e territorit të tyre.

Për Shqipërinë, Institucionet përgjegjëse janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Federata Shqiptare e Sportit: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

3.2 Palët do t'u përmbahen detyrimeve të parashikuara nga Konventa Ndërkombëtare UNESCO kundër dopingut në sporte, e vitit 2005.

### **4. SHKËMBIME MES TË RINJSH**

4.1. Palët do të nxitin shkëmbimin e të rinjve dhe bashkëpunimin mes Shoqatave të të rinjve, me qëllim që të mbështeten shkëmbimet e përvojave dhe njohja e kulturave përkatëse.

### **5. KULTURË DHE ART**

#### **5.1. Institucione kulturore**

5.1.1. Palët do të ndihmojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kulturore të dy vendeve.

Pala italiane informon se në kalendarin e saj vjetor të aktiviteteve kulturore jashtë vendit parashikohen ditë dhe javë kushtuar disa fushave parësore (në veçanti gjuha

italiane, kuzhina, dizajni, arti bashkëkohor, muzika, kinematografia dhe industria krijuese) me veprimtari kulturore që zhvillohen njëkohësisht në të gjithë botën.

## 5.2. Muzikë, Teatër, Vallëzim

5.2.1. Palët në përputhje me legjislacionin kombëtar të secilit shtet do të nxisin dhe mbështesin shkëmbime dhe përfaqësime në festivale dhe aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, të muzikës, baletit, teatrit, artit pamor si dhe pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kulturore, që do të zhvillohen në të dy Vendet. Palët reciprokisht do të informojnë njëra-tjetrën për kushtet, datat dhe programet e aktiviteteve kulturore (shih Aneksi I a.).

5.2.2 Palët do të ndihmojnë bashkëpunimin në projekte të rëndësishme ndërkombëtare, në festivale, konkurse si dhe përmes organizimit të javëve të kulturës së dy Vendeve.

5.2.3 Palët do të ndihmojnë binjakëzimin me teatrot më të njohura të Vendeve respektive konkretisht të Teatrit Kombëtar të Shqipërisë me Teatro Piccolo di Milano dhe Teatro Stabile di Torino.

5.2.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis Arkivave Kombëtarë të Filmit dhe Kinemasë në lidhje me shkëmbimin e përvojave dhe praktikave, për sa i përket digjitalizimit, ruajtjes dhe përhapjes së trashëgimisë së filmit ndërmjet dy Vendeve.

## 5.3 Galeritë dhe Arti Pamor

5.3.1 Palët do të nxisin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë mes galerive dhe institucioneve të tjera për shkëmbimin e ekspozitave të artit nga fondi i galerive të të dy Vendeve sipas pëlqimit të ndërsjellë.

5.3.2 Palët do të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e pikturës, skulpturës dhe gjinitë e tyre nëpërmjet workshop-eve, ekspozitave, shkëmbimit të artistëve.

## 5.4 Kinematografi

5.4.1 Palët do të ndihmojnë bashkëpunimin mes institucioneve publike, institucioneve dhe shoqatave që veprojnë në sektorin kinematografik, përmes realizimit të projekteve të bashkëprodhimit, në bazë të Marrëveshjes dypalëshe të bashkëprodhimit të firmosur më 10 maj 2002 dhe që ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2004.

5.4.2 Palët do të ndihmojnë, ndër të tjera, forma të vlerësimit të kinematografisë të të dy Vendeve, si shkëmbim mes artistëve, pjesëmarrje në festivale, konferenca, takime dhe aktivitete të tjera më rëndësi ndërkombëtare (shih Aneksi I b.; Aneksi II c.).

## 5.5 Festivale, Kremtime, Evente

5.5.1. Palët do të shkëmbejnë informacione dhe dokumentacione për festivale, kremtime dhe evente kulturore me rëndësi të madhe që zhvillohen në këto Vende dhe do të lehtësojnë pjesëmarrjen në to të grupeve apo artistëve veçanërisht të kualifikuar dhe përfaqësues të kulturës italiane dhe shqiptare.

## 5.6. Ekspozita

5.6.1. Palët shprehin dëshirën për të realizuar, gjatë periudhës që ky Program është në fuqi, ekspozita të nivelit të lartë. Detajet përkatëse do të përcaktohen në rrugë diplomatike.

## 6. ARKEOLOGJI, DOKUMENTIM DHE MONITORIM, RESTAURIM, RUAJTJE DHE MBROJTJE E TRASHËGIMISË KULTURORE

6.1. Palët do të nxisin bashkëpunimin në fushat e trashëgimisë kulturore duke mbështetur kontaktet dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studiuesve dhe publikimeve nga institucionet e specializuara si dhe organizimin e eventeve që promovojnë misionet arkeologjike italiane në Shqipëri. Do të inkurajojnë shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe publikimeve në fushën muzeale, mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Administrata italiane përgjegjëse për nismat e përmendura është Ministria e Kulturës, përmes zyrave përgjegjëse.

Administrata shqiptare përgjegjëse për këto iniciativa është Ministria e Kulturës, nëpërmjet Drejtorive dhe institucioneve të varësisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

6.1.1 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet Administratave të tyre arkivore me anë të shkëmbimit të publikimeve shkencore, të kopjeve të dokumenteve në formatin analog ose digjital, të bazave ose të dhënave dhe të dispozitave rregullatore, në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi.

6.1.2 Palët do të shkëmbejnë çdo vit një arkivist për vizita kërkimi ose studimi për një periudhë 10-ditore.

6.2. Palët do të shqyrtojnë mundësitë për bashkëpunimin në fushën e restaurimit të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore përmes shkëmbimit të specialistëve të restaurimit të arkitekturës dhe veprave të artit.

Administrata italiane përgjegjëse për nismat e përmendura është Ministria e Kulturës, përmes zyrave përgjegjëse.

Administrata shqiptare përgjegjëse për këto nisma është Ministria e Kulturës, nëpërmjet Drejtorive dhe institucioneve të varësisë.

6.3. Palët vlerësojnë bashkëpunimin në fushën e arkeologjisë. Palët bien dakord mbi nevojën për të marrë masat e duhura për mbrojtjen dhe vlerësimin e zonave

arkeologjike, me synim koordinimin e nismave të përbashkëta në dobi të siteve të tjera arkeologjike.

6.4 Palët do të bashkëpunojnë në fushën e muzeologjisë, duke iu referuar veçanërisht instituteve muzeore dhe siteve arkeologjike, për qëllime të vlerësimit dhe me objektiva promovues dhe edukues. Palët do të bashkëpunojnë dhe do të shkëmbejnë përvoja në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe të trashëgimisë muzeore.

6.4.1 Palët do të ndihmojnë binjakëzime, të përcaktuara në bazë të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit me muzetë të së njëjtës tipologji: Muzeu Arkeologjik Durrës me Muzeun Arkeologjik Napoli, me bashkëpunime ndërinstucionale dhe të stafeve përkatëse, ekspozita mbi tema të përbashkëta, ekspozita të përkohshme me objekte nga muzetë përkatës.

6.4.2 Palët do të ndihmojnë binjakëzime, të përcaktuara në bazë të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit dhe shkëmbime eksperiencash me Parqet Arkeologjike ndërmjet dy vendeve. Trajnime dhe shkëmbime eksperiencash të përbashkëta të stafeve që përfshihen direkt në parqet arkeologjike.

6.5. Palët do të mbështesin rritjen e bashkëpunimit ndëruniversitar që shtrihet në nisma me rëndësi, si:

- bashkëpunimi midis Universitetit të Bolonjës dhe Institutit të Arkeologjisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike për vlerësimin e territoreve të Zonës së Butrintit dhe Finiqit dhe do të bashkëpunojnë në ndërhyrjen në Parkun e Butrintit;
- bashkëpunimi midis Universitetit të Kieti-Peskara, Institutit të Arkeologjisë në Tiranë dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, bashkëpunimi midis Universitetit të Ferrarës dhe Institutit të Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, bashkëpunimi midis Universitetit të Maçeratës dhe Universitetit të Gjirokastrës "Eqerem Çabej" dhe bashkëpunimi midis Këshillit Kombëtar për Kërkimet (CNR), Institutit të Shkencave të Trashëgimisë Kulturore ISHTK dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për kërkime në arkeologji dhe paleontologji dhe për vlerësimin e trashëgimisë arkitektonike të kryera përkatësisht në Durrës, në jug-perëndim të Shqipërisë, në Adrianopolis-Paleokastër dhe në Shqipërinë e jugut;
- bashkëpunimi ndërmjet qendrave kombëtare të informacioneve mbi njohjen akademike në zhvillimin e Rrjetit AdReN - Adriatic Recognition Network, me seli në Venecia pranë IUAV, për nxitjen e njohjes automatikisht të kualifikimeve dhe projekteve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të mesëm.
- bashkëpunimi me shkollat e nivelit universitar të Istituto Ventrare per il Restauro (*Instituti Ventrare për Restaurimin*) me seli në Romë e Matera, të Opificio delle Pietre Dure (*Fabrika e Gurëve të Fortë*) me seli në Firence dhe të Istituto Centrale per la Patologia degli Archivi e del Libro (*Instituti Qëndror për Patologjinë e Arkivave e Librit*) me seli në Romë, të njohur historikisht si përsosmëri italiane e që lëshojnë një titull studimi të barazvlershëm me diplomën universitare të nivelit të dytë (LRM/02), i cili aftëson në ushtrimin e profesionit të restauruesve të trashëgimive kulturore.

6.6. Palët angazhohen të bashkëpunojnë me qëllim që të luftohet trafiku i paligjshëm i pasurive kulturore me veprime parandaluese, ndëshkuese dhe korrigjuese, sipas legjislacionit përkatës kombëtar dhe në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Ndërkombëtare UNESCO e vitit 1970 për Parandalimin dhe Ndalimin e Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pasurisë Kulturore, dhe duke mbajtur parasysh parimet e Konventës UNIDROIT të vitit 1995 për objektet kulturore të vjedhura apo të eksportuara në mënyrë të paligjshme.

6.6.1 Pala shqiptare angazhohet të krijojë një bazë të dhënash të objekteve kulturore të marra në mënyrë të paligjshme, sipas modelit italian të bazës së të dhënave dhe Pala italiane angazhohet të vërë në dispozicion përvojën e Komandës së Karabinierëve për Mbrojtjen e Trashëgiminë Kulturore, me qëllim që të ndihmojë në krijimin e saj.

6.6.2 Palët dakordësojnë një bashkëpunim dhe mbështetje të ndërsjellë mes Institutit Qendror për Katalogimin dhe Dokumentimin, Zyrave të Eksportimit pranë Ministrisë së Kulturës dhe Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, për zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi procedurat e dokumentimit, katalogimit, monitorimit dhe qarkullimit të lirë dhe luftës kundër trafikimit të pasurive kulturore.

6.6.3 Palët angazhohen të bashkëpunojnë për rritjen e kapaciteteve tekniko-profesionale në fushën e dokumentimit sipas standardeve ndërkombëtare.

Organet italiane përgjegjëse të këtij sektori janë Komanda e Karabinierëve për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Instituti Qendror për Katalogimin dhe Dokumentimin, Zyra për Eksportimin pranë Ministrisë së Kulturës.

Organet shqiptare përgjegjëse janë Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës pranë Ministrisë së Kulturës, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

6.7 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në organizimin e programeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të arkeologjisë.

6.8 Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore sipas legjislacionit të tyre kombëtar për trashëgiminë kulturore nënujore, si dhe në pajtueshmëri me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e UNESCO-s e vitit 2001 mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore.

Organizmat italianë përgjegjës në këtë sektor janë Komanda e Karabinierëve për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe zyrat përgjegjëse të Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Drejtorisë së Përgjithshme së Arkeologjisë, Arteve të Bukura dhe Peizazhit në Ministrinë e Kulturës.

Organizmat përgjegjëse shqiptare janë Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë, Qendra e Studimeve Albanologjike/Institutit Arkeologjik në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Qendra Ndër-operacionale Detare, Roja

Bregdetare, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Prokuroria, Policia e Shtetit.

6.9 Palët angazhohen të bashkëpunojnë në respektim të parimeve të parashikuara në Konventën kuadër të Këshillit të Evropës mbi vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë (Faro, 2005).

Organet italiane përgjegjëse në këtë sektor janë Ministria e Kulturës. Organet shqiptare përgjegjëse janë Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, Akademia e Shkencave dhe Qendra Kombëtare për Veprimtaritë Folklorike.

6.10 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në kuadër të digjitalizimit të trashëgimisë kulturore materiale (objekte dhe site të trashëgimisë kulturore), dokumentare (arkiva, biblioteka etj) si dhe koleksione muzeale.

6.11 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në kuadër të krijimit të Qendrës Shqiptare për Ruajtjen dhe Restaurimin, duke marrë shembullin e "Istituto Centrale per il Restauro", në Romë.

## **7. ART, DESIGN DHE ARKITEKTURË BASHKËKOHORE**

7.1. Palët do të angazhohen në promovimin e arteve pamore bashkëkohore (art, arkitekturë e design), si dhe në zhvillimin e sipërmarrjeve krijuese dhe kulturore që lidhen me to.

7.2. Palët do të promovojnë vlerësimin e trashëgimisë artistike dhe arkitektonike bashkëkohore dhe zbatimin e saj si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, edhe përmes kryerjes së shkëmbimeve të ekspertëve në sektorë të ndryshëm të disiplinave që lidhen me bashkëkohoren.

7.3. Palët do të bashkëpunojnë për organizimin e kurseve formuese mbi historinë dhe kritikën e artit dhe të arkitekturës bashkëkohore.

7.4. Palët do të ndihmojnë lëvizjen dhe shkëmbimet e artistëve të rinj mes dy Vendeve, duke përfshirë rezidenca përkatëse.

7.5. Ministria e Kulturës - Drejtoria e Përgjithshme për Artin, Design-in dhe Arkitekturën Bashkëkohore, në kuadrin e kompetencave të saj dhe në bazë të rekomandimeve të sipër përmendura, është e gatshme të ofrojë ndihmesën e saj teknike për zhvillimin e bashkëpunimeve të mundshme me Vendin e interesuar.

7.6 Organizmat përgjegjëse shqiptare: Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë, Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

## 8. ARKIVA, BIBLIOTEKA, INDUSTRI E LIBRIT

### 8.1. Arkivat

8.1.1. Palët do të mbështesin bashkëpunimin mes Administratave arkivore përkatëse përmes shkëmbimit të botimeve shkencore, të kopjeve të dokumenteve në format analog apo digjital, të bazave të të dhënave dhe dispozitave ligjore, në respektim të legjislacioneve kombëtare në fuqi.

8.1.2. Palët do të shkëmbejnë çdo vit një arkivist për vizita studimore apo kërkimore me një kohëzgjatje 10 ditore (Aneksi II a).

Administrata italiane përgjegjëse është Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme për Arkivat.

Administrata shqiptare përgjegjëse është Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, institucion në varësi të Kryeministrit.

8.1.3. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së Programit, Ministria italiane e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, deklarohet e gatshme të dërgojë një ekspozitë të botimeve arkivore.

8.1.4. Dy Administratat arkivore do të mund të ndjekin realizimin e programeve të përbashkëta edhe përmes marrëveshjeve dypalëshe, duke njoftuar, pa humbur kohë, Ministrinë përkatëse të Punëve të Jashtme.

8.1.5. Palët bien dakord të ndihmojnë bashkëpunimin mes Arkivave historikë të dy Ministrive të Punëve të Jashtme dhe të lejojnë aksesin nga ana e kërkuesve të kualifikuar, në bazë të parimit të reciprocitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi në të dy Vendet.

### 8.2. Biblioteka

8.2.1. Palët do të promovojnë bashkëpunimin ndërmjet bibliotekave të të dy Vendeve, specifikisht nëpërmjet shkëmbimit të publikimeve, eksperiencave, njohurive dhe ekspertëve në përputhje me legjislacionet kombëtare.

Administrata italiane përgjegjëse është Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme për Bibliotekat dhe Institutet e Kulturës.

Administrata shqiptare përgjegjëse është Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, dhe Biblioteka Kombëtare.

8.2.2. Palët do të kryejnë çdo vit shkëmbimin e një bibliotekari, punonjës të bibliotekave përkatëse qendrore, për një vizitë me kohëzgjatje prej tetë ditësh (Aneksi II a).

8.2.3. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij Programi, Pala italiane (Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme për Arkivat dhe Drejtoria e Përgjithshme për

Bibliotekat dhe Institutet e Kulturës) shpreh gatishmërinë e saj, nëse kërkohet, të dërgojë ekspertë në sektorin e ruajtjes, restaurimit, katalogimit, informatikës, godinave të bibliotekave dhe promovimit të pasurive librare. Shpenzimet përkatëse të vizitës do të përballohen nga Pala kërkuese. Hollësitë përkatëse do të përcaktohen në rrugë diplomatike.

### 8.3. Botimet

8.3.1. Palët do të nxisin përkthimin dhe botimin e veprave klasike dhe bashkëkohore me vlerë të lartë artistike që ndihmojnë në një njohje më të mirë të ndërsjellë të letërsisë, të shkencës dhe të artit të të dy Vendeve, duke iu përmbajtur legjislacionit përkatës mbi të Drejtat e Autorit.

8.3.2. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij Programi, Pala italiane (Drejtoria e Përgjithshme për Bibliotekat dhe Institutet e Kulturës, pranë Ministrisë së Kulturës), shpreh gjithashtu gatishmërinë e saj për të dërguar një ekspozitë dhe/ose një përmbledhje botimesh me synimin për të pasqyruar veprimtarinë në kuadër të mbrojtjes dhe të vlerësimit të trashëgimisë librare.

8.3.3. Pala italiane informon se janë të disponueshme këto vlerësime/çmime që mund të jepen për botues dhe përkthyes të librave italianë në gjuhë të huaj.

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Drejtoria e Përgjithshme për Diplomacinë Publike dhe Kulturore, jep çmime apo kontribute financiare, për botues dhe përkthyes italianë dhe/ose të huaj, për përkthimin e veprave letrare dhe shkencore, si dhe për përkthimin, titrimin apo dublimin e filmave me metrazh të shkurtër e të gjatë si edhe të serive televizive.
- Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme për Bibliotekat dhe Institutet e Kulturës jep "Çmime Kombëtare për përkthimin" të cilat janë nën Kujdestarinë e Lartë të Presidentit të Republikës e që u jepen përkthyesve dhe botuesve italianë dhe/ose të huaj.

8.3.4 Pala shqiptare informon se janë të disponueshme këto vlerësime/çmime që mund të jepen për botues dhe përkthyes të librave shqiptarë në gjuhë të huaj.

- Çmimet Kombëtare të Letërsisë;
- Fondi i përkthimit nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe;
- Fondi i përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj;
- Krijimtaria letrare për fëmijë.

8.3.5 Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, mbështet financiarisht botuesit dhe përkthyesit e huaj për përkthimin e letërsisë shqiptare jashtë vendit.

8.3.6 Palët mbështesin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e botimeve përmes shkëmbimit të librave, botimeve periodike, veprave të letërsisë

klasike dhe bashkëkohore etj., vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta midis individëve, shoqatave të botuesve të të dy Vendeve.

8.3.7 Palët mbështesin shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e seminareve, lëvizshmërinë e krijuesve të letrave për njohjen e ndërsjellë të krijimtarisë së të dy Vendeve.

8.3.8 Palët do të ndërmjetësojnë, nxisin dhe mbështesin, brenda hapësirave dhe mundësive praktike përkatëse, vendosjen e marrëdhënieve me qëllim binjakëzimin e institucioneve kulturore kombëtare të trashëgimisë kulturore të Republikës së Shqipërisë me ato homologe në Itali.

## 9. KOMUNIKIMI

9.1. Palët do të ndihmojnë shkëmbimet në fushën e radiofonisë dhe atë televiziv duke nxitur arritjen e marrëveshjeve të drejtpërdrejta mes organizmave përkatës, të përhapjes së sinjalit radio-televiziv, edhe me qëllim inkurajimin e një kuptimi më të mirë të realitetit të të dy Vendeve si dhe thellimin e njohjes së ndërsjellë.

## 10. TË DREJTAT E NJERIUT

10.1 Palët mbështesin veprimtaritë në fushën e arsimit dhe të kulturës që synojnë të garantojnë mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore me një vëmendje të veçantë ndaj çështjes së luftës kundër çdo forme diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor, racizmit, intolerancës dhe ksenofobisë.

10.2 Palët do të nxisin gjithashtu nisma të ngjashme në fushën e arsimit, kryesisht në çështje që lidhen me fushën STEM, me synim përkrahjen e barazisë mes burrit dhe gruas në fushën e kërkimit dhe të punësimit. Departamenti për Shanset e Barabarta pranë Këshillit të Ministrave është i gatshëm të nisë kontaktimin me organet homologe shqiptare.

## 11. DISPOZITA TË FUNDIT

11.1. Ky Program nuk përjashton mundësinë për të dakordësuar në rrugë diplomatike nisma të tjera të paparashikuara në të e paraprakisht të autorizuara nga Administratat përgjegjëse.

11.2. Palët bien dakord që të gjitha nismat e përmendura në këtë Program do të realizohen brenda kufijve të fondeve financiare të përcaktuara nga bilancet përkatëse vjetore.

11.3 Parashikimet e këtij Programi do të gjejnë zbatim në bazë të kuadrit ligjor përkatës, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe, për sa i takon Italisë, me ato që rrjedhin nga përkatësia e saj në Bashkimin Evropian.

11.4. Ky Program do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me anë të së cilave Palët konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të tij dhe do të jetë i vlefshëm deri në nënshkrimin e programit vijues e sidoqoftë jo më vonë se viti 2025.

11.5. Aneksat I dhe II janë pjesë përbërëse e këtij Programi.

Firmosur në TIRANË, më 06.08.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën italiane dhe shqipe, të dy tekstet të njëjtë e me njëjtën vlerë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË Ministri i Kulturës	PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Ministri i Kulturës
	 

## ANEKSI I

### I a.

Institucionet kryesore italiane përgjegjëse për promovimin e spektaklit italian të drejtpërdrejtë jashtë vendit, janë: Ministria për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Ministria e Kulturës; Akademia Kombëtare Silvio d'Amico dhe Akademia Kombëtare e Kërcimit.

Të gjitha nismat që përfitojnë një mbështetje financiare të Ministrisë së Kulturës i nënshtrohen një vlerësimi paraprak pozitiv nga ana e Komisioneve këshilluese të sektorit.

Për Shqipërinë, organet përgjegjëse janë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit dhe Universiteti i Arteve.

### I b.

Në sektorin e kinemasë italiane jashtë vendit institucionet kryesore përgjegjëse për Italinë janë: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Drejtorja e Përgjithshme për Diplomacinë Publike dhe Kulturore dhe Ministria e Kulturës, Drejtorja e Përgjithshme për Kinematografinë, e cila kryen veprimtari mbikqyrëse mbi Institucione të rëndësishme që operojnë në kuadrin kinematografik, si: Istituto Luce Cinecittà S.r.l., Fondazione Centro Sperimentale di Cinematografia - që përfshin Kinotekën Kombëtare dhe Shkollën Kombëtare të Kinemasë - dhe Bienalja e Venecias.

Për Shqipërinë organi përgjegjës është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

## ANEKSI II

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME E FINANCIARE

#### II a. Shkëmbime vizitash (neni 1.1.3, 6.1.2, 6.2.2)

Shkëmbimet e vizitave të parashikuara nga ky Program do të rregullohen si më poshtë:

- 1) Pala dërguese do të njoftojë Palën marrëse, përmes kanaleve diplomatike, të paktën tre muaj përpara, për sa vijon:
- 2) Emri i kandidatit që duhet propozuar, sipas dispozitave të këtij Programi, do të komunikohet nga vendi dërgues;
- 3) Nënshtetësia duhet të jetë italiane apo e një vendi të Bashkimit Evropian për atë që shkon në Shqipëri dhe shqiptare për atë që shkon në Itali;
- 4) Të dhënat e personit të propozuar, *curriculum vitae* i tij dhe informacion mbi njohuritë, nga ana e tij, e një gjuhe komunikimi;
- 5) Programi i propozuar për vizitën, duke paraqitur, sipas rastit, titujt e konferencave, emrin e profesorit ftues dhe emërtimin e departamentit universitar të tij apo institucionin ftues;
- 6) Datat dhe kohëzgjatjen e vizitës;
- 7) Pala dërguese do të përballojë shpenzimet e udhëtimit nga një kryeqytet në tjetrin dhe kthimin;
- 8) Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e qëndrimit sipas kushteve dhe afateve të paraqitura në vijim dhe shpenzimet e udhëtimit brenda territorit kombëtar nga kryeqyteti në selinë universitare në të cilën do të zhvillohet vizita; vetëm për docentët italianë (neni 1.1.3) që shkojnë në Shqipëri, Pala italiane do të përballojë edhe shpenzimet e udhëtimeve të mundshme brenda territorit shqiptar, nga Kryeqyteti në selinë e vizitës.
- 9) Pala pritëse do të duhet të konfirmojë pranimin, nga ana e saj, të vizitës në rrugë diplomatike të paktën një muaj përpara datës së nisjes.

Pala italiane do t' u japë të ftuarve shqiptarë, si në pikën 1.1.3, një dietë ditore prej 120 euro në ditë për gjashtë ditët e para dhe 93 euro për ditën e shtatë e të tetë, dhe për ata të parashikuar në pikat 6.1.2 dhe 6.2.2, një dietë ditore prej 93 euro në ditë, gjithëpërfshirëse.

Pala shqiptare do të kontribuojë në shpenzimet e qëndrimit të të ftuarve italianë në përputhje me kuadrin ligjor për trajtimin e specialistëve të huaj në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe.

Brenda një muaji nga përfundimi i vizitës kërkuesi do të duhet të paraqisë domosdoshmërisht e përmes rrugëve diplomatike një relacion përmbledhës mbi kërkimin e kryer.

#### II b. Bursa studimi (neni 2.1)

- 1) Përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet në secilin prej dy Vendeve nga ana e Ambasadës së vendit ofruës, edhe përmes një Komisioni të Përbashkët.
- 2) Bursistët nuk do të mund të nisen për në vendin ftues pa marrë më parë nga Ambasada e vendit ofruës njoftimin zyrtar lidhur me datën nga e cila mund të fillojë nisja. Dokumentacioni i kandidatëve do të jetë ai i përcaktuar në njoftimet e shpalljes për dhënien e bursave të studimit.

Pala italiane do t'u ofrojë bursistëve shqiptarë trajtimin financiar të përcaktuar në njoftimin e shpalljes për ofrimin e bursave të studimit.

Pala shqiptare do t'u japë bursistëve italianë, për një qëndrim më të gjatë se 30 ditë, një trajtim financiar në përputhje me kuadrin ligjor dhe ligjet në fuqi.

## II c. Kinematografia

Shpenzimet lidhur me organizimin e programeve kinematografike do të dakordësohen, rast pas rasti, mes Palëve në bazë të gjendjes financiare dhe mënyrave ekonomiksht më të leverdishme për vetë Palët.

## II d.

Veprat letrare artistike, muzikore, dramatike, lirike, folkloristike, kinematografike, radiofonike, televizive, si edhe vepra të tjera të një natyre të ngjashme që mbrohen nga legjislacioni për pronësinë intelektuale të njëjës prej Palëve të marrëveshjes, do të gëzojnë, në territorin që është nën juridiksionin e Palës tjetër, mbrojtjen që legjislacioni i kësaj të fundit ia jep këtij lloji vepre, pa paragjykuar sa përcaktohet në Marrëveshjet apo në Konventat ndërkombëtare që të dy Palët kanë nënshkruar.

## II e.

Palët në marrëveshje do të ofrojnë trajtimin më të favorshëm, në përputhje me legjislacionet përkatëse, për personat apo grupet që do të shkojnë në Vendin tjetër për vizita apo veprimtari të parashikuara nga ky Program, si përsa i takon hyrjes, qëndrimit apo largimit të personave nga territori, ashtu edhe përsa i takon importimit të përkohshëm të objekteve të nevojshme për kryerjen e vizitës apo të veprimtarisë.